



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 4577 Prot.

Maliq, më 21.09.2020

**NJOFTIM**

**LËNDA:** Zhvillimin i mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

**DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ**

**KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ**

**Të nderuar,**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, “Funksionimi i këshillit bashkiak”, pika 2, pika 4, neni 56 “Kryetari i këshillit bashkiak” gërma a, dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq” ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq, e cila do të mbahet elektronikisht ditën e **premtë, datë 25.09.2020, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin gusht 2020”;
3. P-V “Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë”;
4. P-V “Për dhënie ndihme financiare” për familjen e z.Jazmi Mollaymeri banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies së zjarrit;
5. P-V “Për rishpërndarjen e fondeve brenda buxhetit të Bashkisë Maliq viti 2020”;
6. P-V “Për miratimin e Raportit të Monitorimit 8-mujor, viti 2020”
7. P-V “Për një shtesë në vendimin nr.152, datë 20.12.2019 të Këshillit të Bashkisë Maliq, “Për nivelin e Taksave dhe Tarifave Vendore, asministrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2020”
8. P-V “Për miratimin e fillimit të procedurës për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandarë, nr.43/45, ZK 2408, Leminot, NJA Pirg, Bashkia Maliq”;
9. Diskutime të tjera.

*Ju faleminderit!*

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ornildi DEMOLLARI**

